



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1084 prot.

Tiranë më, 30.07.2019

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 05, datë 30.07.2019

PËR
MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË PROKURORITË ME JURIDIKSION TË
PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të neneve 148/b shkronja "b", 22, 23 pikat 1 e 2, 30 dhe 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronja "b", 46 pikat 1, 2, 3 shkronja "a", "ç", 61 e 63 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neneve 103, 104, 105, 279 dhe 279/a të Kodit të Procedurës Penale, neneve 2, 3, 7, 10, 14 e 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", neneve 2, 4, 6 pika 2, 18 pika 3 shkronja "b", 21 pika 3 e 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, ligjit nr. 9154/2003 "Për akivat" dhe të akteve europiane të njohura/pranuara¹,

U D H Ë Z O J:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

¹ Shih -Rekomandimet (Rec) 13 (2003) datë 10 Korrik 2003 të Komitetit të Ministrit të Këshillit të Evropës "Për ofrimin e informacionit nëpërmjet medias në lidhje me procedurat penale", Parimet 1 - 19;
- Rekomandimet (Rec) 12 (2010) date 17 Nëntor 2010 të Komitetit të Ministrit të Këshillit të Evropës "Për çështjet e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjësisë të gjyqtarëve" – që janë në interes publik, paragrafi 19 që parashikon "Procedurat gjyqësore dhe çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë janë me interes publik... Gjyqtarët duhet të ushtrojnë përmbytje në marrëdhëniet e tyre me median";
- Magna Carta e Gjyqtarëve, miratuar më 17 Nëntor 2010 nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) në paragrafin 14 (Qasja në drejtësi dhe transparenca) trajton se "Drejtësia duhet të jetë transparente dhe të publikohet informacioni mbi funksionin e sistemit gjyqësor"
- ENCJ (European Network of Councils for the Judiciary - Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësore), Raporti 2017-2018 "Besimi i publikut dhe imazhi i drejtësisë", miratuar në Lisbonë me 1 Qershor 2018, rekomandon "...emërimin e "zëdhënësve", gjyqtarëve ose prokurorëve me trajnime specifike në komunikim dhe krijimin e një "departamenti të specializuar" që punëson profesionistë në komunikim nën drejtimin e "gjykatësit / prokurorit të shtypit".

1. Ky udhëzim ka qëllim të unifikojë veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm në marrëdhëniet me publikun dhe median për dhënien e informacionit në lidhje me hetimin e ndjekjen penale dhe për aktivitete të tjera të prokurorive në këtë fushë.

2. Ky udhëzim njëson dhe përcakton nga kush, kur dhe në çfarë mënyre mund të jepen të dhënat për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale si dhe aktivitetet e tjera të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të cilat do t'i shpërndahen publikut.

Neni 2 Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi janë:

- a) Forcimi dhe lehtësimi i komunikimit ndërmjet organit të prokurorisë dhe publikut.
- b) Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi rolin, kompetencat dhe veprimtarinë e prokurorisë.
- c) Promovimi dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së publikut në parandalimin e krimit, si dhe në procesin e reformave në të cilat prokuroria është e përfshirë.
- ç) Transparenca dhe llogaridhënia publike e prokurorisë, duke ruajtur integritetin, pavarësinë dhe paanësinë.

Neni 3 Përkufizimet

1. Ky udhëzim ka qëllim të unifikojë veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm në marrëdhëniet me publikun dhe median për dhënien e informacionit në lidhje me hetimin e ndjekjen penale dhe për aktivitete të tjera të prokurorive në këtë fushë.

Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së prokurorisë, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga ky institucion.
- b) “Shërbimet për marrëdhëniet me publikun” në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë².
- c) “Prokurori për marrëdhëniet me publikun” është prokurori i caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë për të mbikëqyrur të gjithë procesin dhe procedurat e marrëdhënies së prokurorisë me publikun.³
- ç) “Koordinatori” është nëpunësi civil për marrëdhëniet me publikun i caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë për të ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë sipas ligjit⁴.
- d) “Person” është çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, si dhe personat pa shtetësi.
- dh) “Program transparence” është tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga institucioni i prokurorisë në zbatim të ligjit⁵.
- e) “Komunikim” është komunikimi i të dhënave personale, një ose më shumë subjekteve të caktuara, të ndryshme nga i interesuari, nga përfaqësuesi i titullarit të institucionit, nga personat përgjegjës dhe të ngarkuarit, në çdo formë, edhe përmes vënies në dispozicion ose për konsultime.
- ë) “Media” nënkupton të gjitha nivelet dhe format e komunikimit, private, publike dhe të internetit, nëpërmjet shtypit, televizionit, radios ose shërbimeve të internetit.
- f) “Konfidencialiteti” është mbrojtja e informacionit nga aksesimi i paautorizuar.

KREU II

² Shih, nenin 61 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

³ Shih, po aty.

⁴ Shih, po aty pikën 4 të nenin 61 dhe ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

⁵ Shih, po aty nenet 4 e 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

PARIMET E KOMUNIKIMIT DHE BALANCIMI I INTERESAVE

Neni 4

Parimet e komunikimit

1. Shpërndarja e informacionit tek publiku bazohet në parimet e mëposhtme:
 - a) Publiku ka të drejtën e marrjes së informacionit dhe mediat kanë për detyrë të japin informacione për çështje me interes publik⁶, siç janë hetimi dhe ndjekja penale e veprave penale dhe të gjitha aktivitetet e tjera të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.
 - b) E drejta për marrjen e informacionit dhe detyrimi për dhënien e informacionit mund të bjerë në kundërshtim me parimet e tjera⁷, siç janë, por pa u kufizuar në, mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve (sidomos të drejtat e të dyshuarve, të pandehurve dhe viktimave) dhe mbrojtjen e jetës private.
 - c) Në rast konflikti mes parimeve të përmendura më sipër, duhet të ruhet ekuilibri i duhur midis secilit prej tyre.
 - ç) Gjatë shpërndarjes së informacionit tek publiku, informacioni duhet të jetë objektiv, i saktë, i besueshëm, i qartë dhe i parashikuar në kohë.
 - dh) Shpërndarja e informacionit duhet të përpiqet të promovojë dhe ruajë transparencën dhe besimin e publikut tek institucioni prokurorisë.

Neni 5

Balancimi i interesave

1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm sigurojnë qasje në informacionin për publikun lidhur me veprimtarinë e këtij institucioni.
2. E drejta e publikut për informacion balancohet me përgjegjësinë dhe kompetencat e prokurorisë në funksion, si të mbrojtjes së hetimit dhe ndjekjes penale, ashtu dhe mbrojtjes së sigurisë publike⁸.
3. Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm i kushtojnë vëmendje të veçantë mbrojtjes së jetës dhe sigurisë të viktimave, dëshmitarëve dhe të drejtës së privatësisë.
4. Prokurori i kushton vëmendje, interesit të ruajtjes së fshehtësisë së hetimit kur tejkalon interesin e publikut ose interesit të të pandehurit kur tejkalon interesin e publikut.

KREU III

CILËSIA, PËRMBAJTJA DHE KUFIZIMET NË DHËNIEN E INFORMACIONIT

Neni 6

Cilësia e informacionit

⁶ Shih, praktikën gjyqësore të GJEDNJ (vendimet -ECtHR, 7 June 2007, Dupuis and others vs. France (no. 1914/02), -ECtHR, 29 March 2016, Bédat vs. Switzerland (no. 56925/08) dhe -ECtHR, 6 June 2017, Y vs. Switzerland (no. 22998/13)), nga konkludohet se: "Praktika gjyqësore gjithmonë parashtron se mediat (gazetarët, autorët, gazetatat, revistat, radiot, televizionet etj.) kanë të drejtë të informojnë publikun për hetimet penale dhe procedimet penale dhe se publiku ka të drejtë të marrë informacione për kriminelët hetimet dhe procedurat penale."

⁷ Shih, po aty vendimet e GJEDNJ mësipër nga konkludohet se: "...e drejta për shpërndarjen e informacionit mund të bjerë në konflikt me interesat e rëndësishme publike dhe private të cilat janë të mbrojtura nga ndalimi i zbulimit të informacionit të mbuluar nga sekreti i hetimeve penale. Këto interesa lidhen me autoritetin dhe paanshmëria e gjyqësorit, efektiviteti i hetimit penal dhe e drejta e të akuzuarit për prezumimin e pafajësisë dhe mbrojtjen e jetës së tij private."

⁸ Shih, po aty, vendimet e GJEDNJ me siper dhe (-ECtHR, 26 April 1979, The Sunday Times vs. The United Kingdom (no. 6538/74)) nga konkludohet se: "Balancimi i interesave, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, përcakton se cili interes tejkalon."

Çdo prokurori e juridiksionit të përgjithshëm ka detyrimin që të ofrojë informacion të saktë, objektiv dhe në kohë të arsyeshme.

Neni 7 **Përmbajtja e informacionit**

1. Për të gjitha dokumentet e përpunuara në mënyrë manuale, të cilat përmbajnë të dhëna personale, merren masa shtesë për të parandaluar zbulimin e paligjshëm, shkatërrimin, dhe humbjen si në institucionin e prokurorisë, ashtu edhe gjatë transferimit të tyre nga ky institucion.

2. Për të dhënat personale, në çdo rast duhet të bëhet i pamundur leximi i tyre, ose të anonimizohen duke i bërë të dhënat personale me përmbajtje të palexueshme.

3. Në rast të transferimit automatik të të dhënave personale, rrugët e transmetimit, ose dokumentet që përmbajnë këto të dhëna duhen koduar,⁹ duke përdorur mënyra dhe fuqi koduese në përputhje me rezultatin e vlerësimit të rreziqeve të kryera paraprakisht.

4. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, përpunimi i informacionit bëhet nga koordinatori i informacionit.

Neni 8 **Kufizimet në dhënien e informacionit**

1. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:

a) sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;¹⁰

b) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale;

c) mbarëvajtjes së hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;

ç) mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;

d) barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjes së procesit gjyqësor;

dh) mbarëvajtjes së marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare.

2. E drejta e informimit kufizohet edhe në rast se:

a) Informacioni do të dëmtojte integritetin, dinjitetin, sigurinë, ose të drejtën për privatësi të ndonjë personi;

b) Informacioni që kërkohet është sekret shtetëror;

c) Informacioni do të zbulonte identitetin e një viktime;

ç) Informacioni do të shkelte të drejtat e njeriut;

d) Informacioni do të shkelte të drejtat e të miturve.

3. Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

Neni 9 **Detyrimi për të mbrojtur sekretet hetimore**

1. Aktet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevoje për vazhdimin e hetimeve, prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit dhe ndalimin

⁹ Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (Ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, datë 26.4.2012; nr. 120/2014, datë 18.9.2014), neni 10, paragrafi 3.

¹⁰ Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" (ndryshuar me Ligjin nr.9541, datë 22.5.2006) (Ndryshuar me ligjin 25/2012)

e publikimit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve. Urdhri shoqërohet me përpilimin dhe nënshkrimin e deklaratës për ruajtjen e sekretit hetimor dhe ndalimin e publikimit, bashkëlidhur Aneksi 1.

2. Prokurori mund të lejojë, me vendim të arsyetuar, publikimin e akteve të veçanta ose të pjesëve të tyre. Aktet e publikuara depozitohen në sekretarinë e prokurorisë.

3. Edhe kur aktet nuk mbrohen më nga sekreti, sipas paragrafit 1, të këtij neni, në rastet kur është e nevojshme për vazhdimësinë e hetimeve, prokurori mund të disponojë me vendim të arsyetuar:

a) detyrimin e ruajtjes së sekretit për akte të veçanta, kur i pandehuri jep pëlqimin ose kur njohja e përmbajtjes së aktit mund të pengojë hetimet ndaj personave të tjerë;

b) ndalimin e publikimit të përmbajtjes së akteve të veçanta apo të dhënave të posaçme që lidhen me veprime hetimore të caktuara.

4. Në rastet kur prokurori ka marrë njoftim se media disponon akte që përbëjnë sekret hetimor ose akte që ndalohet publikimi i tyre, për të cilat prokurori ka disponuar me vendim detyrimin e ruajtjes së sekretit dhe/ose ndalimin e publikimit të përmbajtjes së tyre, menjëherë një kopje të këtij vendimi ia dërgon medias përkatëse për zbatim, me qëllim për të ndaluar publikimin e akteve dhe të përmbajtjes së tyre.

Neni 10

Ndalimi i publikimit të aktit

1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv.

2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake.

3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.

4. Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale.

5. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra në regjistrin e njoftimit të veprave penale deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale.

6. Prokurori i çështjes me vendim të arsyetuar vendos ndalimin e publikimit të aktit, i cili ekzekutohet nga koordinatori për median.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË PROKURORI

Neni 11

Marrëdhëniet me median

1. Vetëm shërbimi për marrëdhëniet me publikun është i autorizuar, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, në veçanti ligjit për të drejtën e informimit¹¹, ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale¹² dhe dispozitave të këtij udhëzimi, të informojë publikun për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale, si dhe veprimtaritë e tjera të prokurorive.

¹¹ Ligji nr.119 / 2014 "Për të drejtën e informimit".

¹² Ligji nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

2. Prokurori i marrëdhënieve me publikun, i caktuar për këtë qëllim nga drejtuesi i prokurorisë, udhëheq dhe mbikëqyr shërbimin e marrëdhënieve me publikun¹³.

3. Drejtuesi i prokurorisë emëron një nëpunës civil si kordinator për marrëdhëniet me publikun (këtu e më poshtë kordinator), i cili është përgjegjës për detyrat e përcaktuara në nenin 16 të këtij udhëzimi dhe është nën autoritetin e prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun.

4. Çdo informacion i ofruar nga shërbimi/zyra e marrëdhënieve me publikun duhet të ketë pëlqimin paraprak të drejtuesit të prokurorisë.

5. Shërbimi/zyra e marrëdhënieve me publikun i përgjigjet kërkesave të publikut dhe të mediave dhe merr iniciativa për të informuar publikun, nëpërmjet medias, për ngjarjet kriminale.

Neni 12

Format e shpërndarjes së informacionit

1. Shërbimi/zyra e marrëdhënieve me publikun vendos se në çfarë forme do të kryhet shpërndarja e informacionit, në varësi kjo edhe në rrethanat e rastit.

2. Informacioni i publikut mund të shpërndahet në çdo formë, por pa u kufizuar në:

- a) Komunikimin me median;
- b) Paketa Informativë për Median nëpërmjet prezantimeve të fakteve dhe tabelave;
- c) Intervistat për median;
- ç) Konferencat e shtypit të fokusuara në çështje me rëndësi publike;
- d) Tryeza të rrumbullakëta me përfaqësuesit e mediave;
- dh) Botimet në faqet zyrtare të internetit;
- e) DVD dhe mënyra të tjera të komunikimit digjital;
- ë) Broshura shpjeguese dhe literatura të tjera të shtypura;
- f) Artikuj dhe blogje;
- g) Pjesëmarrje në aktivitet të veçanta të medias;
- gj) Fushatat për ngritjen e vetëdijes publike;
- h) Mediat sociale.

Neni 13

Pasaktësia në raportim

1. Shërbimi i marrëdhënieve me publikun dhe/ose prokurori i çështjes, nëpërmjet prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun, kur konstaton se ka pasaktësi në raportimin e dhënë në media lidhur me veprimtarinë e prokurorisë, menjëherë përgënjeshtrojnë pasaktësinë në raportim dhe bën njoftimin/raportimin e saktë për publikun dhe median në mënyrë korrekte, sipas procedurës.

2. Në rastet kur lajmet dhe artikujt në media kanë të bëjnë me informacione për gjithë sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm ose kur është i përfolur emri i ndonjë prokurori apo zyrtari që punon në sistemin e prokurorisë, shërbimi i marrëdhënieve me publikun ose drejtuesi i prokurorisë njofton personat/autoritetet në institucionet kompetente sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 14

Koordinimi brendshëm

¹³ Shih, piken 2 të nenit 61 të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

1. Drejtuesi i prokurorisë, prokurori i caktuar për marrëdhëniet me publikun, prokurori i çështjes bashkëpunojnë ngushtë ndërmjet tyre dhe në afatin sa më të shkurtër kohor, që t'i ofrojnë informacionin e kërkuar publikut.

2. Prokurori i marrëdhënieve me publikun njofton menjëherë drejtuesin e prokurorisë për çdo çështje me ndjeshmëri, seriozitet dhe rëndësi të veçantë lidhur me imazhin e prokurorisë, për shkak të natyrës së fakteve ose natyrës së subjekteve të përfshira ose çështjeve ligjore që lindin, me kompleksitet të veçantë dhe veçanërisht delikate.

3. Prokurori i marrëdhënieve me publikun, sipas kërkesave të drejtuesit të prokurorisë, bashkëpunon për ecurinë e ndjekjes penale të rastit me koordinatorin e zyrës për marrëdhëniet me publikun për mbledhjen dhe analizimin e informacionit që duhet të komunikohet. Ata sigurojnë organizimin e duhur të informacionit edhe gjatë takimeve me median, të cilat konsiderohen si të përshtatshme nga drejtuesi i prokurorisë për një komunikim efektiv.

4. Drejtuesi i prokurorisë, së bashku me prokurorin e marrëdhënieve me publikun zgjedhin modalitetet, konferencat për shtyp, takimet më pak formale, deklaratat apo njoftimet e llojeve të ndryshme, në lidhje me natyrën specifike të objektit që komunikohet, dhe duke marrë parasysh nevojën për:

- a) afatet kohore, korrektësinë dhe efektivitetin e komunikimit;
- b) trajtim të barabartë në media, duke përfshirë përdorimin e internetit dhe mediave sociale;
- c) përgjegjësinë e administrimit të zyrës dhe imazhin e institucionit;
- ç) shmangien e anësisë në komunikim;
- d) uljen e rrezikut të ndikimit të papërshtatshëm tek gjyqtari dhe publiku;
- dh) mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të personave të përfshirë në procedurën penale.

Neni 15

Prokurori i çështjes

1. Asnjë koment publik nuk duhet të bëhet, për asnjë rrethanë që ka lidhje me ndonjë hetim të hapur ose ndjekje penale, pa pëlqimin paraprak të dhënë nga prokurori përgjegjës i çështjes.

2. Prokurori i çështjes është i detyruar të përgjigjet sa më shpejt që të jetë e mundur me shkrim, mbi kërkesat e prokurorit për marrëdhëniet me publikun për të shkëmbyer informacion rreth hetimeve dhe ndjekjes penale në vazhdim. Prokurori çështjes kujdeset që një kopje e përgjigjes së tij të mbahet në fashikullin e prokurorit.

3. Prokurori i çështjes nuk është i detyruar të ndajë informata kur konfidencialiteti është i nevojshëm të ruhet në një hetim për të mos rrezikuar rezultatin e hetimit.

4. Çdo prokuror është i detyruar të informojë në kohë, me shkrim, prokurorin për marrëdhëniet me publikun nëse është në hetim apo në ushtrimin e ndjekjes penale të një çështje me karakter të ndjeshëm për publikun. Prokurori kujdeset që një kopje e përgjigjes së tij të mbahet në dosje.

5. Raste me karakter të ndjeshëm për median do të konsiderohen në çdo rast:

- a) krime të rënda (me ose pa viktimë);
- b) rastet për qytetarë me profil të lartë publik ose të njohur;
- c) rastet kur janë përfshirë institucionet zyrtare dhe/ose kompani shqiptare.

6. Përpara shpërndarjes nëpërmjet mediave të të dhënave për publikun, në rastet me karakter të ndjeshëm për median, prokurori për marrëdhëniet me publikun, në koordinim me prokurorin e çështjes, duhet fillimisht të marrë pëlqimin paraprak drejtuesit të prokurorisë.

7. Viktima e veprës penale ka të drejtë të kërkojë informacion sipas legjislacionit procedural penal.

Neni 16

Kordinatori

1. Koordinatorin për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit "Për të drejtën e informimit", duke u konsultuar me dokumentin original ose duke marrë një kopje të tij;

b) krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në ligji¹⁴;

c) bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacion brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në ligjin "Për të drejtën e informimit";

ç) regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;

d) dërgon kërkesën për informim tek një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në ligjin "Për të drejtën e informimit", kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;

dh) verifikon rastet për dhënie falas të informacionit qytetarëve;

e) kryen njoftimet paraprake, si dhe komunikon me kërkuar, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

ë) kontrollon, përpunon dhe është përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë veprimtarisë së prokurorisë në bazë të ligjeve dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 17 Procesi penal

1. Vetëm zyra/prokurori i marrëdhënieve me publikun është e/i autorizuar të adresojë mediat para, gjatë dhe pas seancës në gjykatë.

2. Kur është e nevojshme ose e dëshiruar, zyra/prokurori i marrëdhënieve me publikun në prokurori komunikon ose konsultohet me zyrën e marrëdhënieve me publikun të gjykatës përpara se të shpërndajë informacionin për publikun dhe mediat.

3. Para fillimit të seancës dhe gjatë seancës në gjykatë, zyra/prokurori e/i marrëdhënieve me publikun mund të shpjegojë pse prokurori ka vendosur të ndjekë penalisht të pandehurin(t).

a) Të dhënat e mëtejshme rreth seancës dëgjimore i rezervohen gjykatës.

b) Zyra/prokurori i marrëdhënieve me publikun refuzon komentet mbi rrjedhën e procedurave dhe vendimet e gjykatës.

4. Në rast se gjykata ka marrë një vendim kundër të cilin mund të paraqitet ankim, zyra/prokurori e/i marrëdhënieve me publikun mund ta informojë publikun nëse prokurori i çështjes do të apelojë ose jo vendimin e gjykatës.

a) Në rastet kur ushtrohet ankim kundër vendimit të gjykatës arsyet e ankimit mund t'i njoftohen/shpërndahen publikut.

5. Gjatë seancës në gjykatë, prokurori i çështjes, duhet të ndjekë rregullat dhe vendimet e gjykatës për sa i përket marrëdhënieve me publikun dhe mediat në sallën e gjyqit.

Neni 18 Hetime të përbashkëta

1. Në rast të hetimeve të përbashkëta, vetëm njëra zyrë e marrëdhënieve me publikun do të merret me përcjelljen e informacionit në publik.

2. Në bashkërendimin e veprimtarive sipas ligjit¹⁵, prokuroritë bien dakord se cili prokuror për marrëdhëniet me publikun do të shpërndajë informacionin.

Neni 19 Shërbimi për marrëdhëniet me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme

¹⁴ Shih, pikën 1 të nenit 8 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

¹⁵ Shih, nenin 306 pika 1 e K.Pr.Penale.

1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm informojnë zëdhënësin/këshilltarin për marrëdhëniet me median në Prokurorinë e Përgjithshme përpara se të shpërndajnë informacion në media në lidhje me:

- a) hetimet me karakter të ndjeshëm për publikun/median;
- b) hetimet e përbashkëta;
- c) hetimet ndërkufitare;
- ç) rastet e ushtrimit të rekurseve në Gjykatën e Lartë për çështjet me karakter të ndjeshëm për publikun.

2. Për raste të veçanta, të cilat janë në interes për opinionin publik, përpara dhënies së informacionit për publikun, drejtuesi i prokurorisë përkatëse, njofton Prokurorin e Përgjithshëm, dhe kur ndërthuren interesat me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, njofton kryetarin e tij. Në çdo rast nuk mund të publikohet informacioni pa dhënien e pëlqimit nga Prokurori i Përgjithshëm ose Kryetari i KLP-së.

3. Zëdhënësi/këshilltari për marrëdhëniet me median në Prokurorinë e Përgjithshme:

a) me pëlqimin paraprak të Prokurorit të Përgjithshëm del përpara medias dhe jep qëndrimin institucional të prokurorisë në njoftimet për shtyp, sqarimet, reagimet, deklaratat, raportet ose publikimet zyrtare apo elektronike;

b) kujdeset për shpërndarjen e njoftimeve/informacioneve organeve të informimit publik lidhur me aktivitetet e prokurorisë;

c) ofron ndihmë metodike prokurorëve për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm për përgatitjen e konferencave të shtypit, takimeve ose intervistave me gazetarë;

ç) përgatit shkrime të artikujve të ndryshëm dhe/ose përgjigje nëpër gazeta apo organe të tjera të medias për të qartësuar pasaktësitë e publikimeve të dhëna prej tyre në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë;

d) mirëmban arkivin e fotografive, videove dhe materialeve të nevojshme për nevojat e qasjes raportuese dhe/ose kordimitit historik/kronologjik të tyre lidhur me aktivitetet e Prokurorit të Përgjithshëm;

dh) kujdeset për menaxhimin dhe azhurnimin e vazhdueshëm të faqes/adresës elektronike zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, ku adresohen kërkesat e qytetarëve dhe medieve;

e) bashkërendon me median për veprimtari që synojnë edukimin e shoqërisë në drejtim të njohjes me ligjin ose parandalimin e kriminalitetit.

Neni 20

Faqja zyrtare e sistemit të prokurorisë

1. Sistemi i prokurorisë ka një portal unik, në të cilin janë të integruara prokuroritë e të gjitha niveleve me juridiksion të përgjithshëm.

2. Portali përditësohet dhe mirëmbahet nga zëdhënësi/këshilltari për marrëdhëniet me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, prokurorët për marrëdhëniet me publikun dhe kordinatorët e caktuar për marrëdhëniet me publikun, në bashkërendim me Sektorin e Informatikës.

3. Në portalin e sistemit të prokurorisë publikohen të gjithë dokumentet dhe materialet e shkruara dhe audiovizuale të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë udhëzim të përgjithshëm.

Neni 21

Raportimi periodik i veprimtarisë të prokurorive

1. Prokurorët në prokuroritë e të gjitha niveleve me juridiksion të përgjithshëm që sigurojnë të dhëna të përcaktuara në këtë nen, i dërgojnë tek prokurori për marrëdhëniet me publikun për përpilimin e raportit njëzet e katër orësh për veprimtarinë e të gjitha prokurorive.

2. Prokurori për marrëdhëniet me publikun, të gjitha informacionet e nevojshme që nuk çenojnë ruajtjen e sekretit hetimor dhe ndalimin e publikimit, duhet t'ia dërgojë zëdhënësit/këshilltarit për marrëdhëniet me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili ia dërgon për njoftim medias.

3. Raporti periodik njëzet e katër orësh duhet të përmbajë të dhëna lidhur me:

- a) Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit;
- b) Kërkesat për caktimin e masave të sigurimit "arrest në burg";
- c) Kërkesat për arrestimin, përfshirë edhe ato ndërkombetare;
- ç) Kontrolltet;
- d) Sekuestrimet preventive dhe konservative;
- dh) Numrin e çështjeve për të cilat është ngritur akuza në gjykatë, veçanërisht ato për vepra penale kundër korrupsionit dhe/ose shpërdorim detyre;
- e) Njoftime për kërkesat e prokurorëve në gjykatë dhe vendimet përkatëse gjyqësore që evidentojnë arritjet/rezultatet e prokurorisë;
- ë) Raste të tjera që vlerësohen se janë me interes për publikun.

4. Prokurori për marrëdhëniet me publikun harton raportin mujor bazuar në raportet periodike njëzet e katër orëshe.

Neni 22

Policia Gjyqësore

1. Me referimin e veprës penale nga policia gjyqësore në prokurori, në momentin që prokurori urdhëron regjistrimin e procedimit penal, policia gjyqësore ndërpret çdo komunikim me publikun dhe mediat për të dhënat në atë referim, pa pëlqimin e prokurorit të çështjes dhe prokurorit për marrëdhëniet me publikun.

2. Në raste me interes publik, prokuroritë përkatëse, në ambientet e tyre mund të organizojnë konferenca shtypi të përbashkëta me policinë e shtetit.

3. Në dhënien e informacionit në konferenca shtypi duhet të respektohen rregullat e këtij udhëzimi të përgjithshëm.

Neni 23

Marrja e kopjeve, ekstrakteve ose vertetimeve

1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes me çështjen mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vertetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive.

2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak. Në rastet e pranimit të kërkesës, prokurori i çështjes përcakton aktet apo ekstraktet për të cilat do të jepet kopje.

3. Prokurori i çështjes, pasi nxjerr urdhrin për pagimin e shpenzimeve dhe masën e tyre, koordinon me sekretarinë pranë prokurorisë për kryerjen e fotokopjimit dhe inventarizimin e akteve, si dhe kujdeset për mbrojtjen e të dhënave personale që përmbajnë aktet.

4. Kryesekretari, pas verifikimit të pagimit të shpenzimeve nga kërkuesi, kundrejt nënshkrimit në procesverbal, dorëzon aktet dhe/ose ekstraktet përkatëse.

5. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vertetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit.

6. Prokurori i çështjes përpara dorëzimit të kopjeve të akteve në kryesekretari, urdhëron ndalimin e publikimit të akteve dhe/ose ruajtjen e sekretit hetimor.

Neni 24

Përgatitja dhe aprovimi i programit të transparencës

1. Çdo prokurori e juridiksionit të përgjithshëm vendos në zbatim programin institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

2. Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm mbajnë parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;

b) vënien në dispozicion pa kërkesë, të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion.

Neni 25

Kategoritë e të dhënave të cilat mund të bëhen publike pa kërkesë

1. Në përputhje me programin e miratuar të transparencës, çdo prokurori vendos në dispozicion të publikut, në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme, në mjediset e pritjes së publikut dhe në këndin e njoftimit të institucionit, informacionin e parashikuar në ligjin “Për të drejtën e informimit”¹⁶.

2. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë; i saktë; i përditësuar; i thjeshtë në konsultim; i kuptueshëm; lehtësisht i aksesueshëm;¹⁷

Neni 26

Komunikimi dhe shfrytëzimi i dokumenteve të fondit arkivor për qëllime shkencore¹⁸

1. Të dhënat arkivore të prokurorisë, ku përfshihen dosje, regjistra dhe akte të tjera të këtij institucioni që i nënshtrohen procedurës së arkivimit dhe që ruhen, përpunohen dhe administrohen nga shërbimi i arkivit të prokurorisë në bashkëpunim me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor¹⁹, mund të bëhen publike për qëllime shkencore ose për nevoja vetjake, në mbështetje të dispozitave të Kreut VII të ligjit “Për arkivat”²⁰ dhe akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave²¹.

2. Shërbimi i marrëdhënieve me publikun, në bashkërendim me shërbimin arkivor në prokurori, mbi kërkesën e subjekteve të interesuar, kur plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore që parashikon pika 1 e këtij neni, pasi është dhënë miratimi/autorizimi me shkrim nga drejtuesi i prokurorisë apo nga personi që ai i ka deleguar kompetencat e tij²², realizon këshillimin e një dokumenti arkivor ose dhënien e fotokopjeve të vertetuara/certifikuara të tij, në të cilin shënohen treguesit arkivorë të origjinalit²³, në sasinë dhe kundrejt tarifave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të ligjit²⁴.

KREU V

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

¹⁶ Shih, nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”;

¹⁷ Shih, pikën 1 seksioni II i Urdhërit nr. 14, datë 22.1.2015 “Për miratimin e programit model të transparencës i komisionerit për të drejtën e informimit dhe të dhenave personale”.

¹⁸ Shih, neni 10 i ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave Personale” (Ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, datë 26.4.2012; nr. 120/2014, datë 18.9.2014).

¹⁹ Shih, nenin 63 të ligjit nr.97/2016 dhe ligjin nr.9154/2003“Për arkivat” e “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

²⁰ Shih, nenet 53-79, Keun VII i ligjit nr.9154/2003 dhe nenin nenin 103 pika 3 të K.Pr.Penale;

²¹ Shih, Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, i plotësuar me vendimin nr.10 datë 31.10.2017 të tij;

²² Shih, nenin 70 pika 1 e ligjit nr.9154/2003 dhe nenin 37 i “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, itë miratuar me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave;

²³ Shih, nenet 38 e 39 tek “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave;

²⁴ Shih, nenet 77 e 78 të ligjit nr.9154/2003;

Neni 27
Trajnime

1. Drejtuesi i prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm sigurohet që prokurori i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe nëpunësi civil për marrëdhëniet me publikun të marrin trajnimet e specializuara (fillestar dhe të vazhdueshëm) në fushën e komunikimit me median dhe marrëdhëniet me publikun.

Neni 28
Përgjegjësia disiplinore

Shkeljet e ligjeve përkatëse²⁵ dhe të këtij udhëzimi të përgjithshëm nga prokurori, oficeri/agjenti i policisë gjyqësore i seksionit/shërbimeve ose nëpunësi civil apo punonjësi i prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë shkelje të disiplinës në ushtrimin e detyrës dhe/ose shkak për fillimin e hetimit disiplinor ndaj secilit prej tyre.

Neni 29
Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen prokurorët, prokurorët/kordinatorët për marrëdhëniet me publikun, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe nëpunësit civil në prokuroritë pranë gjykatave të të gjitha niveleve me juridiksion të përgjithshëm, si dhe oficerët/agjentët e policisë gjyqësore të shërbimeve në të gjithë nivelet dhe llojet e policive apo agjencive të zbatimit të ligjit që me ligj u njihet ky funksion.

2. Drejtuesit e prokurorive në të gjitha nivelet me juridiksion të përgjithshëm janë përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi.

Neni 30
Hyrja në fuqi dhe publikimi

1. Urdhëri nr. 257, datë 14 Dhjetor 2005, "Për komunikim me publikun dhe mediat, si dhe për ruajtjen e sekretit të veprimeve hetimore" dhe çdo akt normativ që bie në kundërshtim me këtë udhëzim të përgjithshëm, shfuqizohen.

2. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU



²⁵ Shih, parashikimet në dispozitat e ligjeve si më poshtë:

-nenet 103, 279 e vijues të K. Pr. Penale;

-nenet 9, 89 e vijues të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";

-nenit 7 pika 1 e vijues të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

-nenet 8, 33 pika 4 shkronja "a" e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR

DEKLARATË
PËR RUAJTJEN E SEKRETIT DHE NDALIMIN E PUBLIKIMIT

Në _____, me _____, ora _____, unë, _____, prokuror në Prokurorinë e rrethit gjyqësor _____, në bazë të neneve 103, 104, 105/3 e 279 të K. Pr. Penale, marr këtë deklaratë për ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit të akteve sekrete ose të akteve të hetimit që ndalohet publikimi i tyre, nga _____ funksioni ose lidhja që ka me procedimin _____

Aktet procedurale me të cilat është njohur ose që i janë lëshuar kopje, estrakte ose vertetime janë _____
(Shënohet akti/et, klasifikimi nëse është i klasifikuar, numri i faqeve, e të dhëna të tjera që vlerësohen të nevojshme për tu pasqyruar në deklaratë)

Njohja me aktet filloi në datë _____ ora _____ dhe përfundoi në datë _____, ora _____.

Në përfundim të njohjes me aktet, _____, deklaroj se:
Prokurori më paralajmëroj:

Për përgjegjësinë penale që unë kam, në bazë të nenit 295/a paragrafi i katërt i K. Penal, nëse do të nxjerr aktet sekrete ose të dhëna që përmbajnë aktet sekrete për të cilët ndalohet publikimi, si dhe;

Për përgjegjësinë disiplinore që unë kam, në bazë të nenit 104 të K. Pr. Penale, nëse do të shkel ndalimin e publikimit të akteve që ndalojet publikimi i tyre.

Deklarata u lexua dhe nënshkruhet pa vërejtje.

DEKLARUESI

PROKURORI